



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 345/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-55948-03-15-2018 me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike për vitin 2018”, me fond limit 4,166,600 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

**Ankimues:**

“B 360” shpk  
Rruga “Papa Gjon Pali i II”, Pallati 11/1, Ap.11 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore (DPPTV)  
Rruga e Kavajës, ish Uzina Mekanike, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.03.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF- 55948-03-15-2018 me objekt: “*Blerje pajisje kompjuterike për vitin 2018*”, me fond limit 4,166,600 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.

II.3. Në datën 21.03.2018 operatori ekonomik “B360” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- Në kriteret e kualifikimit ju keni kërkuar: *Per garantimin me suport teknik gjatë periudhës së garancisë për mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:*
- *1 (një) specialist të certifikuar në MSCE për Infrastrukure Desktop.*


- (një) Inxhinier elektronik të çertifikuar ITIL per menaxhimin e shërbimeve IT
- Procedura e prokurimit që do të zhvillohet nga ana juaj është një kontratë malli në bazë të nenit 27 të VKM nr.914 datë 29.12.2014. Në asnjë nga paragrafet e VKM-së nuk ka ndonjë kusht apo kërkesë që ti pëafrohet sadopak kriterëve të vendosura nga ana juaj. Përtej limiteve që ka përkufizuar shumë qartë ligji , AK nuk mund të vendosë kriterë subjective, spekulante dhe disproporcionale me objektin e prokurimit. Për sa më sipër është mjaft e qartë që kërkesa e bërë nga AK është e tepruar dhe bie në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me lëvrim të pajisjeve. Në asnjë pjesë të specifikimeve teknike nuk është kërkuar të bëhet instalimi apo konfigurimi i pajisjeve.
- Për më tepër kompjuterat janë kërkuar me sistem të parainstaluar Windoës 10 64 bit dhe vënia e tyre në prizë dhe ndezja e tyre mund të bëhet nga cdo profesion IT dhe nuk do të ishte e nevojshme ekzistenca e kualifikimeve si MCSE Destktop Infrastructure dhe ITIL. Në rast se do të bëni një kërkim të thjeshtë certifikata MCSE Destktop Infrastructure tregon se personi mund të vendosë dhe menaxhojë desktop dhe pajisje të tjera që ofrojnë akses nga kudo duke ruajtur sigurinë dhe pajtueshmërinë. Gjithahstu vërteton aftësitë tuaja në infrastrukturën virtuale të desktopit, shërbimet e desktopit në remote dhe virtualizimin e aplikacioneve. Kjo certifikatë kërkohet kur një operator ofron të menaxhojë pajisjet në distancë pa ardhur fare në ambjentet e klientit. Pra nëse ofruesi i shërbimit IT ka kosto të lartë që të vijë ta bëjë shërbimin tek zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ofron si alternativë më pak të mirë por e pranueshme të bëjë shërbimin remote. Në këtë rast DPPTV edhe sikur të kërkonte shërbime IT të kontrollit të pajisjes që sikurse vërtetë me sipër nuk është kusht i tenderit , nuk mund të kërkojë certifikata profesionale për Remote Management si kriter skualifikues kur shërbimi që pretendohet do të kryhet On Site pra do të kontrollohen fizikisht në zyrat e DPPTV dhe jo nga katmanduja me remote desktop infrastructure.
- Ndërsa certifikata ITIL është një certifikatë e cila lëshohet për Menaxhimin e Shërbimeve IT në nivele profesionale dhe në rastin kur kemi të bëjmë vetëm me lëvrimin e 55 kompjuterave detyra e tij do të ishte pa vlerë. Mbulimi i kushteve të garancisë nuk ka lidhje me njohuritë që teston dhe certifikon ITIL. Vëtë kompanitë e prodhimit të harduer kanë skema të qarta dhe persona të paracaktuar që merren me mbulimin e garancive dhe nuk e lënë në mëshirë të fatit sikurse mund të kenë merakun e madh AK. Në shumicën e rasteve shoqëria që mbulon garancitë nuk është operatori ekonomik që shet produktin.
- Përse kërkohet inxhinier elektronik certifikatë ITIL. Kërkoni një elektronik për punën e një kompjuteristi. Një inxhinier kompjuterësh, një inxhinier rrjeti, një ekspert informatike etj etj. Nuk e paskan të drejtën për të marrë ITIL dhe për të instaluar disa desktop tek DPPTV-ja??.
- Përse niveli i certifikatës së ITIL nuk është përcaktuar??. Apo sepse fituesi i paracaktuar ka në stafin e tij një inxhinier elektronik me certifikatë ITIL Foundation level e cila është në faqen zyrtare të ITIL mund të fitohet me 2.5 ditë trajnimi cilido qoftë profesioni yt. Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit.

- Në kriteret e kualifikimit ju keni kërkuar që : Operatori duhet të paraqesë një deklaratë që e disponon sasinë e mallit të kërkuar, pra OE duhet ta ketë në gjëndje. Ndërkohë keni kërkuar që lëvrimi i pajisjeve do të jetë për 20 ditë. Dy kërkesat e mësipërme janë kontradiktore me njëra tjetrën. Nga njëra anë kërkohet që produktet të jenë gjëndje ndërkohë që nga ana tjetër duhet të lëvrohen për 20 ditë. Në mënyrë që të mos ketë mundësi për keqinterpretime ju lutem përcaktoni qartë se sa është periudha e lëvrimit dhe hiqni kriteret e lidhura me kohën që bie në kundërshtim me periudhën e kërkuar të lëvrimit. Përcaktoni qartë sa është periudha e lëvrimit të produkteve dhe korrigjoni kriteret e tenderit që nuk janë në harmoni me periudhën e kërkuar të lëvrimit.

II.4. Në datën 26.03.2018 me shkresën nr.26509/1 prot, autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke modifikuar kriterin për punonjës të certifikuar por nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Në datën 30.03.2018 pala ankimuese “B360” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr.26508/3 prot., datë 11.04.2018 protokolluar me tonën me nr.650/2 datë 13.04.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.



### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B360” shpk për heqjen e kriterit *Per garantimin me suport teknik gjatë periudhës së garancisë për mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë: 1 (një) specialist të certifikuar në MSCE për Infrastrukure Desktop; (një) Inxhinier elektronik të certifikuar ITIL per menaxhimin e shërbimeve IT me arsyetimin se “Procedura e prokurimit që do të zhvillohet nga ana juaj është një kontratë malli në bazë të nenit 27 të VKM nr.914 datë 29.12.2014. Në asnjë nga paragrafet e VKM-së nuk ka ndonjë kusht apo kërkesë që ti pëafrohet sadopak kriterëve të vendosura nga ana juaj. Përtej limiteve që ka përkufizuar shumë qartë ligji , AK nuk mund të vendosë kriterë subjektive, spekulante dhe disproporcionale me objektin e prokurimit. Për sa më sipër është mjaft e qartë që kërkesa e bërë nga AK është e tepruar dhe*

bie në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me lëvrim të pajisjeve. Në asnjë pjesë të specifikimeve teknike nuk është kërkuar të bëhet instalimi apo konfigurimi i pajisjeve. Për më tepër kompjuterat janë kërkuar me sistem të parainstaluar Windows 10 64 bit dhe vënia e tyre në prizë dhe ndezja e tyre mund të bëhet nga cdo profesion IT dhe nuk do të ishte e nevojshme ekzistenca e kualifikimeve si MCSE Desktop Infrastructure dhe ITIL.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3./11 e “Kapaciteti Teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Per garantimin me suport teknik gjatë periudhës së garancisë për mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:
- 1 (një) specialist të çertifikuar në MSCE për Infrastrukure Desktop.
- (një) Inxhinier elektronik të çertifikuar ITIL per menaxhimin e sherbimeve IT

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar furnizimin me produkte, në të cilën njëherazi është përfshirë edhe periudha e garancisë. Konkretisht, në lidhje me produktin Kompjuter desktop është parashikuar garanci për 3 vite si më poshtë:

KOMPJUTERA

Desktop

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët min. për procesorin sipas: cpu benchmark.net</b>	7000
<b>Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:</b>	
<b>“RAM”:</b>	8 GB, DDR4 2133 MHz Non-ECC
<b>Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:</b>	500 GB
<b>Shpejtësia e Hard Diskut “Media sizes”:</b>	7200 Rpm SATA 6.0Gb/s
<b>“Disk subsystem controler”:</b>	Serial ATA 6.0 Gb/s
<b>Karta Grafike “Graphics”:</b>	≥ 1 GB

<b>“Media Device”:</b>	<i>DVD+/-RË</i>
<b>“Slots”:</b>	<i>Minimum (3) PCI/PCI-E, nga te cilat (1) x16 PCI-E.</i>
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Porta e komunikimit “Ports”:</b>	<i>Min. (8) USB nga te cilat: a. min (2) USB Para b. min (2) USB 3.0  (1) RJ-45, (1) audio in/out, (1) mic. and headphone, (1)  VGA.</i>
<b>“Netëorking”:</b>	<i>(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port.</i>
<b>“Sound”:</b>	<i>Integrated Sound Card</i>
<b>“Speakers”:</b>	<i>Internal or Built-in Monitor</i>
<b>“Siguria “Security Management”:</b>	<i>Embedded Security TPM</i>
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:</b>	<i>OEM Ëindoës 10 64-bit Professional</i>
<b>“Keyboard”:</b>	<i>Standart Keyboard QËERTY</i>
<b>“Mouse”:</b>	<i>Minimum 3 Button scroll Optical</i>
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	<i>220 V AC, 50 Hz</i>
<b>AKSESORËT</b>	

<b>Kabëll “Power Cord”:</b>	<i>European</i>
<b>Recover CD :</b>	<i>Recover CD/DVD ose Recover Partition</i>
<b>MONITORI</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	<i>LCD OSE LED i të njëjtës markë me kompjuterin</i>
<b>Madhësia “Size” :</b>	<i>21”</i>
<b>Rezolucioni “Native Resolution”:</b>	<i>1920 x 1080 at 60 Hz</i>
<b>Raporti I kontratit “Constrast Ratio Static”:</b>	<i>1000:1</i>
<b>“Display Port”:</b>	<i>(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DVI/HDMI/DP</i>
<b>Koha e rifreskimit “Response Time”:</b>	<i>≤ 8 ms</i>
<b>Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:</b>	<i>Energy Star</i>
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	<i>220V AC, 50 Hz</i>
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e mbulimit të garancisë “Warranty”:</b>	<i>3 vjet</i>

*Referuar Udhezimit nr. 2 date 02.09.2013 te Keshillit te Ministrave “Per standardizimin e hartimit te termave te references per projektet TIK ne administraten publike”, komisioni u bazua ne standartet TIK te Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacioni dhe nevojave te institucionit për bazë materiale, me qëllim kryerjen e detyrave funksionale nga ana e secilit sektor.*

*Sa me siper jane dhene parametrat e pajisjes kompjuterike qe kerkohet nga Autoriteti Kontraktor.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që

*autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

*Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.5. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit lidhur me kriterin e sipërcituar sqarohet se:

- *AK ka përcaktuar se në zbatim të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë mund tu kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të cilat shërbejnë suportin e OE gjatë periudhës së garancisë së mallit të kërkuar objekt prokurimi. Në zbatim të nenit 30 të VKM së mësipërme kjo kërkesë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit apo ofertuesit. A K nuk ka kërkuar plotësimin e pikës 2.3 për kapacitetin teknik me qëllim realizimin e shërbimit të morëmbajtjes së pajisjeve të kërkuara objekt prokurimi. Por në zbatim të nenit 77 “Mbikqyrja e Kontratës të VKM nr.914 datë 29.12.2014 AK kërkon që gjatë zbatimit të kontratës përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë së mallit për cdo defekt apo dëmtim të mallit objekt prokurimi të ketë të përfshirë garancinë se OE i cili do të shpallet fitues të ketë kapacitetin teknik për mbulimin e garancisë ashtu sic është shprehur në DST e procedurës së prokurimit. Gjithsesi për të mos i lënë vend për interpretime në lidhje me plotësimin e kriterëve të DST nga OE gjykon se:*
- *Për pikën 2.3 kapaciteti teknik : Per garantimin me suport teknik gjatë periudhës së garancisë për mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:*
- *1 (një) specialist të certifikuar në MSCE për Infrastrukure Desktop.*
- *(një) Inxhinier elektronik të certifikuar ITIL per menaxhimin e shërbimeve IT.*

**U modifikua në:**



- *Per garantimin me suport teknik gjatë periudhës së garancisë për mallrat objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:*
- *1 (një) specialist të certifikuar në MSCE për Infrastrukure Desktop.*
- *(një) Inxhinier elektronik të certifikuar ITIL per menaxhimin e sherbimeve IT.*

*Ose*

*Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht dy punonjës të certifikuar për servisin e pajisjeve të brand-it të mallit që oferton.*

III.1.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi heqjen e kriterit të sipërcituar, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.1.7. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për identifikimin dhe riparimin e pajisjeve objekt prokurimi (për periudhën së garancisë). Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka parashikuar se operatorët ekonomikë ofrojnë garanci për produktet si më poshtë vijon: *Kompjutera desktop* është parashikuar garanci për 3 vite. Në rastin konkret, KPP konstaton se, kontrata e mësipërme objekt prokurimi, krahas furnizimit me mallra, përmban njëherazi edhe garancinë e produkteve për periudhën e kërkuar, për të cilën (në lidhje me identifikimin dhe riparimin e problemit) shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit teknik të kualifikuar, duke mos qenë para rastit klasik të kontratës të furnizimit me mallra. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor e modifikuar në lidhje me stafin e kualifikuar është një kërkesë e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar.

III.1.8. Referuar arsytimit të sipërcituar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin e lartpërmenduar duke u lënë hapësirë operatorëve ekonomikë të disponojë minimalisht dy punonjës të certifikuar për servisin e pajisjeve të brand-it të mallit që ofertojnë dhe jo domosdoshmërisht të certifikuar në *MSCE për Infrastrukure Desktop, dhe ITIL per menaxhimin e sherbimeve IT*, në funksion të hapjes së konkurrencës dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

III.1.9. Gjithashtu lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se autoriteti kontraktor nuk ka bërë publikimin e shtojcës për modifikimin e dokumentave të tenderit, KPP tëheq vemendjen e autoritetit kontraktor për publikimin e shtojcës në sistemin e prokurimeve elektronike, në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet*

çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B360” shpk se “Në kriteret e kualifikimit ju keni kërkuar që : Operatori duhet të paraqesë një deklaratë që e disponon sasinë e mallit të kërkuar, pra OE duhet ta ketë në gjëndje. Ndërkohë keni kërkuar që lëvrimi i pajisjeve do të jetë për 20 ditë. Dy kërkesat e mësipërme janë kontradiktore me njëra tjetrën. Nga njëra anë kërkohet që produktet të jenë gjëndje ndërkohë që nga ana tjetër duhet të lëvrohen për 20 ditë. Në mënyrë që të mos ketë mundësi për keqinterpretime ju lutem përcaktoni qartë se sa është periudha e lëvrimit dhe hiqni kriteret e lidhura me kohën që bie në kundërshtim me periudhën e kërkuar të lëvrimit. Përcaktoni qartë sa është periudha e lëvrimit të produkteve dhe korrigjoni kriteret e tenderit që nuk janë në harmoni me periudhën e kërkuar të lëvrimit.

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 /5“Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatori duhet të paraqesë një deklaratë që e disponon sasinë e mallit të kërkuar, pra OE duhet ta ketë në gjëndje.

III.2.2. Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Sasia e mallit që kërkohet:

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmimi/leke pa tvsh</b>
1	Kompjuter + Desktop	55	

*Afatet e lëvrimin: Duke filluar që nga dita e lidhjes së kontratës produktet do të lëvrohen me përfundim të plotë të të gjithë objektit të kontratës brenda 20 ditëve kalendarike*

III.2.3. Referuar pretendimit sa më sipër të ankimuesit se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e deklaratës për mallin që të jetë gjendje dhe kërkesa e autoritetit kontraktor për lëvrimin e mallit brenda 20 ditëve, KPP e gjen të pabazuar pasi në këto kërkesa nuk ka asnjë kontradiktë. Në rastin konkret kërkesa për paraqitjen e deklaratës për mallin është vendosur tek kriteret kualifikuese. Ndërsa afati i lëvrimin të mallit është përcaktuar në shtojcën 10 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit”. Pretendimet e ankimuesit janë konfuze pasi afati i lëvrimin të mallit nuk ka lidhje me deklaratën që duhet të dorëzojnë operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit.

Akoma më tej, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues drejtuar KPP ngrihet pretendimi për heqjen e kriterit *Operatori duhet të paraqesë një deklaratë që e disponon sasinë e mallit të kërkuar, pra OE duhet ta ketë në gjëndje*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se pretendimi për heqjen e kriterit nuk është ngritur pranë autoritetit kontraktor por vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke mos ndjekur kështu shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 dhe 7 parashikohet se: *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”* (pika 2) *“Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme”* (pika 7).

Operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte ngritur këtë pretendim pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (*ipso lege*), pretendimi i operatorit ekonomik “B360” sh.p.k i cili nuk është ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merret në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B360” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF- 55948-03-15-2018 me objekt: “*Blerje pajisje kompjuterike për vitin 2018*”, me fond limit 4,166,600 lekë pa tvsh, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 26.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “B360” shpk.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 650 Protokoli, Datë 30.03.2018**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**